



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**"HASAN PRISHTINA"**  
**UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 857  
Datë: 18/3/2024

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" (KQZ UP) bazuar në nenin 22 të Rregullores për Procedurën Zgjedhore, Themelimin dhe Punën e Parlamentit Studentor dhe Këshillave të Studentëve të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", nr.753, datë 07.03.2024, përmes procedurës qarkulluese, sipas nenit 41 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me datë 17.03.2024, në mënyrë unanime nxjerr:

**VENDIM**

**Për rregullat e fushatës zgjedhore për Organizatat Studentore të Certifikuara, si dhe veprimet e ndaluara përgjatë heshtjes zgjedhore**

1. Përgjatë fushatës zgjedhore, për zgjedhjet studentore, Organizatat Studentore të certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhje (OS) mund të organizojnë dhe mbajnë tubime publike, tryeza të rrumbullakëta, konferenca për shtyp, intervista, fjalime ose ndonjë aktivitet tjetër të ngjashëm, nëpërmjet të cilave ata mund t'i shprehin lirisht mendimet e tyre, me qëllim të fitimit të përkrahjes nga votuesit e tyre studentë si dhe mund të publikojnë dhe shpërndajnë afishe, reklama dhe material tjetër, lidhur me një fushatë zgjedhore.
2. Organizatat Studentore të certifikuar (OS), nuk mund të mbajnë tubime përgjatë fushatës zgjedhore, brenda hapësirës së objekteve të njëjësive akademike dhe Universitetit.
3. OS që dëshirojnë të organizojnë një tubim përgjatë fushatës zgjedhore, duhet të njoftojnë KQZ UP të paktën 24 orë më herët, si dhe t'i njoftojnë organet e tjera kompetente, sipas legjislacionit në fuqi.
4. OS duhet të realizojnë tubimet publike, përgjatë fushatës, në pajtim me rregullat dhe legjislacionin në fuqi për tubimet publike.
5. Në fushatën zgjedhore të studentëve, është e ndaluar të përfshihen personeli akademik dhe administrativ i Universitetit të Prishtinës.
6. Në aktivitetet e fushatës zgjedhore që realizojnë OS, nuk mund të përfshihen në asnjë formë personat të cilët nuk kanë statusin e studentit në Universitetin e Prishtinës.

7. OS e certifikuara, nuk mund të përdorin gjatë fushatës zgjedhore, hapësirat të cilat janë të dedikuara për Këshillat e Studentëve dhe Parlamentin e Studentëve dhe nuk mund t'i shfrytëzojnë njëanshëm ato hapësira.
8. OS, për gjatë fushatës nuk mund të publikojnë materiale të fushatës zgjedhore në faqet e autorizuara të Këshillave të Studentëve, Parlamentit të Studentëve ose faqet tjera të autorizuara të Universitetit të Prishtinës, si dhe nuk mund t'i përdorin emailat zyrtar të Këshillave të Studentëve dhe të Parlamentit të Studentëve, për qëllime të fushatës zgjedhore.
9. OS e certifikuara për pjesëmarrje në zgjedhje, u ndalohet që të vendosin poster dhe afishe të tjera, brenda objekteve të Fakulteteve si dhe Universitetit.
10. Të gjitha materialet e shtypura, ato audiovizuale dhe materialet e tjera të zgjedhjeve, përfshirë ato online, duhet ta mbajnë emrin e OS të certifikuar që e ka porositur përgatitjen e materialit të tillë.
11. Cilado OS certifikuar lejohet të ekspozojë materialin e vet të zgjedhjeve në atë mënyrë që, të mos e pengojë pamjen e materialeve të zgjedhjeve që u përkasin OS të tjera të certifikuara, si dhe pamjen e simboleve të Universitetit dhe të Fakultetit.
12. Vendosja e posterëve, afisheve apo materialeve të tjera në vendet e lejuara, bëhet në atë mënyrë dhe përmes aksesorëve të tillë (ngjitës apo tjetër), që sigurojnë mosdëmtimin dhe pastrimin e lehtë të murit apo të sipërfaqes tjetër në cilën vendoset materiali, gjatë dhe pas heqjes së tyre (para fillimit të heshtjes zgjedhore).
13. KZF-të e Fakulteteve përkatëse duhet aktivisht të monitorojnë zbatimin e këtyre rregullave zgjedhore, përgjatë fushatës.
14. Përgjatë periudhës së heshtjes zgjedhore, bazuar në dinamikën zgjedhore OS-ve i ndalohen veprimet si në vijim:
  - 14.1. Mbajtja e takimeve për qëllime të fushatës zgjedhore;
  - 14.2. Shpërndarja ose ekspozimi i çfarëdolloj materiali të fushatës zgjedhore në hapësirat e brendshme dhe të jashtme të Universitetit;
  - 14.3. Tubimi ose kërkimi i mbështetjes në çfarëdo forme, përfshirë edhe përmes postimeve online;
  - 14.4. Organizimi i çfarëdo takimi tjetër, që mund të asociojë me fushatën zgjedhore dhe kërkesën për mbështetje;
  - 14.5. Shpërndarja e çfarëdo materiali zgjedhor në mënyrë fizike apo online.

15. KZF dhe OS janë të obliguara që të raportojnë parregullësitë në KQZ UP.
16. Në rast të shkeljes së këtij vendimi, ndaj OS dhe individëve do të shqiptohen masat e përcaktuara në Rregullores për Procedurën Zgjedhore, Themelimin dhe Punën e Parlamentit Studentor dhe Këshillave të Studentëve të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", nr.753, datë 07.03.2024, kurse ndaj personave të paautorizuar që nuk janë student dhe që cenojnë këto rregulla do të iniciohen procedura sipas legjislacionin në fuqi.
17. Ky vendim hyn në fuqi, në momentin e miratimit nga KQZ UP.

### Arsyetim

Ky vendim është nxjerrë në kuptim të kompetencave të KQZ UP për menaxhimin e procesit zgjedhor si dhe zbatimin e dinamikës zgjedhore, me qëllim të zhvillimit të një procesi zgjedhor objektiv dhe me integrim si dhe të barabartë për të gjitha Organizatat Studentore, pjesëmarrëse në zgjedhjet studentore.

### KQZ UP

**Prof. Ass. Dr. Florent Muçaj – Kryesues**



**Prof. Ass. Dr. Kujtime Boshtrakaj Camaj - Zv.Kryesuese**

**Besfort Krasniqi, Sekretar i Përgjithshëm – Anëtar**